



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Bulevardi "Zogu I", Godina 57/2, Nr. 18 Tiranë

Tel/Fax 04 2226814 ; 2226814

Nr. 636/5 Prot.

Tiranë, më 30.12.2016

V E N D I M

Nr.171, datë 30.12.2016

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 636/1, datë 28.10.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacionit të protokolluar pranë Komisionerit me nr. 514 prot., datë 03.08.2016, për disa pretendime të ngritura në lidhje me zhvillimin e procedurës së ecurisë disiplinore dhe vlerësimit të rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor 2016, për punonjësin *****,

VËREJ SE:

Pas njohjes me informacionin që përmbante kërkesa e parashtruar prej nëpunësit ***** me urdhrin nr. 636/1, dt. 28.10.2016, të Komisionerit ka nisur verifikimi paraprak i çështjes, në përfundim të të cilit, rezultoi sa më poshtë:

Nëpunësi ***** është nëpunës civil me detyrë "Specialist jurist", në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Njësinë Administrative Nr. 8, të Bashkisë Tiranë.

Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit rezulton se, nga drejtuesi (Administratori) i njësisë Administrative Nr. 8, me shkresën nr. 1674 prot, datë 18.08.2016, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burimeve Njerëzore, të Bashkisë Tiranë, (në cilësinë e njësisë përgjegjëse) është kërkuar fillimi i ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit ***** me motivacionin: "Mospërbushje të detyrave, për shkak të mosparaqitjes në seancën gjyqësore të datës 27.07.2016, ku Njësia Administrative ka qenë e thirrur në cilësinë e palës së paditur dhe për shkak të largimit pa arsye gjatë orarit zyrtar, në datën 26.07.2016 (për të cilin është mbajtur procesverbali përkatës)".

Shkeljet e mësipërme, të cilat nga ana e administratorit janë konsideruar si mospërmbushje e detyrave, në kuptim të nenit 57, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, klasifikohen si shkelje të rënda disiplinore dhe në zbatim të nenit 59, pika 2, të po këtij ligji, organi kompetent për shqyrtimin e tyre është Komisioni Disiplinor.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme, Kryetari i Bashkisë Tiranë me urdhrin nr. 26175, datë 31.08.2016, ka ngritur Komisionin Disiplinor, ku konstatohet se në përbërjen e tij është përfshirë dhe administratori i Njësisë Administrative Nr. 8, në cilësinë e eprorit direkt për ankuesin. Për nisjen e ecurisë disiplinore, Komisioni disiplinor me shkresën nr. 66175/1, datë 02.09.2016, ka njoftuar, rregullisht, nëpunësin *****.

Komisioni Disiplinor, pas shqyrtimit të shkeljes së pretenduar, në seancat dëgjimore të zhvilluara respektivisht në datat 14.09.2016 dhe 22.09.2016, me vendimin nr. 26175/2, datë 30.09.2016, ka vendosur marrjen e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, ndaj nëpunësit *****; masë kjo që i është njoftuar këtij të fundit, me shkresën nr. 26175/3, datë 13.10.2016.

Në të njëjtën kohë, rezulton se për nëpunësin *****; është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2016, nga ku konstatohet të jetë vlerësuar me nivelin 4, “Jo kënaqshëm”. Nga këqyrja e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë, konstatohet që ky proces është kryer vetëm nga administratori i njësisë administrative, i cili në ndarjen D, “Nënshkrimi” të këtij formulari, rezulton të ketë nënshkruar njëkohësisht në cilësinë e zyrtarit raportues, zyrtarit kundërfirmues dhe zyrtarit autorizues.

Nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, vlerëson se në zhvillimin e procedurave të mësipërme ndaj nëpunësit *****; ka mangësi të elementëve thelbësorë proceduralë, të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e interpretimit të gabuar të dispozitave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, në të cilat përcaktohet hollësisht procedura që duhet të ndiqet si dhe personat kompetentë, të ngarkuar nga ligji për zhvillimin e tyre.

Në rastin në fjalë, rezulton se, për nëpunësin *****; ecuria disiplinore ka filluar me motivacionin e mospërmbushjes së detyrave të pozicionit të punës. Në kuptim të nenit 57, pika 3, germa “a”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, shkeljet e mësipërme klasifikohen si “shkelje të rënda disiplinore”.

Në nenin 59, pika 2, të po këtij ligji, përcaktohet se organi kompetent për shqyrtimin e shkeljeve të kësaj natyre është Komisioni Disiplinor. Më tej, në vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen e Komisionit Disiplinor në shërbimin civil”, është përcaktuar në mënyrë të detajuar përbërja e Komisionit Disiplinor dhe procedura konkrete që duhet të ndiqet nga ky organ, për shqyrtimin e shkeljes së pretenduar.

Konkretisht, në Kreun I, pika 3, të aktit normativ të mësipërm përcaktohet se Komisioni Disiplinor për bashkitë, duhet të ketë 5 anëtarë dhe duhet të ketë përbërjen si më poshtë:

- a) *Nëpunësin më të lartë civil në atë institucion;*
- b) *Eprorin direkt të nëpunësit civil për të cilin ka nisur ecuria disiplinore;***
- c) *Drejtuesin e njësisë përgjegjëse për atë institucion;*
- d) *Nëpunësin më të vjetër civil të institucionit ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore*
- e) *Nëpunësin më të vjetër të njësisë ku punon nëpunësi për të cilin ka nisur ecuria disiplinore.*

Nisur nga sa më sipër, konstatohet se në rastin konkret përbërja e Komisionit Disiplinor është e parregullt, pasi rezulton se Administratori i Njësisë Administrative Nr. 8, ka marrë pjesë në shqyrtimin e ecurisë disiplinore, duke mos përmbushur asnjë nga kushtet e të qenit anëtar, të parashikuara në dispozitën e sipërcituar. Kjo paligjshmëri ka ardhur si rrjedhojë e faktit se, njësia përgjegjëse (*njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Tiranë*), në kushtet e një interpretimi dhe zbatimi të gabuar të ligjit të posaçëm të shërbimit civil, i ka atribuar drejtuesit të njësisë administrative kompetencat e eprorit direkt për nëpunësit civilë që ushtrojnë detyrën e tyre në këto struktura.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në kuadër të trajtimit dhe vlerësimit të rolit të administratorit në fushën e shërbimit civil, konstaton faktin se njësitë administrative ushtrojnë kompetencat dhe funksionet e tyre mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", (i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015). Ky ligj, në nenin 44/1, pika 1 dhe 2 të tij, përcakton në mënyrë të shprehur se:

1. *Në njësitë administrative funksionon administrata, që drejtohet nga administratori.*
2. *Administratori emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë dhe është përgjegjës para tij për funksionimin dhe veprimtarinë e administratës...*

Nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme, në vështrim të mënyrës së fillimit dhe përfundimit të marrëdhënies së punës për administratorin, përcaktohet se ai nuk është subjekt i ligjit për shërbimin civil. Për më tepër, në kuptim të nenit 44/2, të po këtij ligji, ku përmenden shprehimisht detyrat e administratës së njësisë administrative, nuk rezulton që administratori të ketë kompetenca në administrimin e shërbimit civil, për nëpunësit civilë të njësive administrative.

Nga ana tjetër, neni 44/2, pika 1, germa "h", të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, "*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*", i ndryshuar, përcakton të drejtën e administratorit për të kryer çdo funksion tjetër të deleguar nga Kryetari apo Këshilli i Bashkisë. Nga dokumentacioni i administruar, i vënë në dispozicion nga Bashkia e Tiranës, nuk provohet ekzistenca e ndonjë akti, me anë të të cilit Kryetari i Bashkisë Tiranë, në bazë të neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative i RSH*", t'i ketë deleguar administratorit në fjalë, kompetenca në fushën e shërbimit civil. Për këtë arsye, ky i fundit nuk mund të marrë kompetencat e eprorit direkt ndaj nëpunësve civilë të njësive administrative. Për sa më sipër, në kuptim të nenit 59, pika 4/b, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, roli i administratorit në zhvillimin e ecurisë disiplinore mund të paraqitet në atë të "*zyrtarit me detyra*

kontrolli hierarkik mbi nëpunësin civil”, e cila në këtë rast, përlligj vetëm të drejtën e këtij të fundit për të kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore.

Mungesa e kompetencës së administratorit për të vepruar në cilësinë e eprorit direkt, për nëpunësit civilë të njësive administrative, përcaktohet qartë dhe në nenin 4, pika 1, germa “e”, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, i cili jep përkufizimin e nocionit të eprorit direkt, sipas së cilit me këtë cilësi paraqiten:

- i) *Titullari i institucionit për nëpunësit civil të kategorisë së lartë drejtuese, përfshirë nëpunësit në pozicionet e koordinatorit të posaçëm dhe drejtuesit e institucioneve të varësisë;*
- ii) *Sekretari i përgjithshëm apo nëpunësi në pozicionin ekuivalent me të, për drejtorët e drejtorive dhe drejtuesit e degëve territoriale të institucionit;*
- iii) *Titullari i institucionit të varësisë për drejtorët brenda këtij institucioni;*
- iv) ***Drejtor i drejtorisë për të gjithë nëpunësit e pozicioneve të tjera;***

Nga përmbajtja e dispozitës së sipërcituar, rezulton se, në cilësinë e eprorit direkt për pozicionet e punës *“përgjegjës sektori”* dhe *“specialist”*, paraqitet pozicioni i punës *“drejtor i drejtorisë”*. Nga verifikimi i strukturës aktuale të njësive administrative të Bashkisë Tiranë, rezulton se ato janë të organizuara në nivel sektori dhe pozicioni i *“drejtorit të drejtorisë”* nuk është parashikuar në të. Mungesa e këtij pozicioni në strukturën aktuale të njësive administrative, nuk legjitimon administratorin të paraqitet në cilësinë e eprorit direkt, por nga ana tjetër tregon edhe një mangësi në kuadrin e ndërtimit dhe funksionimit të një strukture të përshtatshme, për një ushtrim sa më të drejtë e të ligjshëm, të pushtetit diskrecional të Kryetarit të Bashkisë.

Kjo dhe për faktin se, në kuptim të nenit 44/1, pika 3, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, *“Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”*, i ndryshuar, njësitë administrative nuk janë subjekte që veprojnë me vete, por janë pjesë e strukturës dhe organikës së Bashkisë Tiranë. Në këtë këndvështrim, konstatohet se në përbërjen e strukturës aktuale të Bashkisë Tiranë, është parashikuar ekzistenca e *“Drejtorisë së objekteve në bashkëpronësi dhe zhvillimit të marrëdhënieve me Komunitetin dhe njësitë administrative”*, e cila nga informacioni i marrë prej njësisë përgjegjëse të këtij institucioni, paraqitet si përgjegjëse për bashkërendimin e marrëdhënieve me njësitë administrative, por që nuk rezulton të ketë ndonjë kompetencë të shprehur, në drejtim të shpërndarjes dhe harmonizimit të kompetencave të Kryetarit të Bashkisë tek strukturat ndihmëse e vartëse.

Parimi i një shërbimi civil të qëndrueshëm, përcakton detyrimin e kësaj strukture dhe të njësisë përgjegjëse, në marrjen e masave të nevojshme prej kryetarit të bashkisë, për unifikimin/ekuivalentimin e funksionit të eprorit direkt, në përputhje me përcaktimet e dispozitave të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe të delegimit të mundshëm të kompetencave, sipas nevojave të ushtrimit të autoritetit të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, nëse rastet e plotësimit të kushteve të sipërcituara.

Në kuadër të garantimit të të drejtave që gëzojnë nëpunësit civilë, delegimi i kompetencës dhe evidentimi i funksionit të eprorit direkt, përbën një domosdoshmëri për respektimin e ligjshmërisë së procedurave, ku eprori direkt është organi kompetent për zhvillimin e tyre (si

procedurat disiplinore, procedura e konfirmimit të nëpunësit civil, në përfundim të periudhës së provës, vlerësimet vjetore, etj..).

Duke analizuar gjithë sa më sipër, nga mos ekzistenca e akteve të nevojshme, të cilat provojnë delegimin e kompetencave, si dhe unifikimin/ekuivalentimin e funksioneve të eprorit direkt, arrihet në konkluzionin se, drejtuesi i njësisë administrative nuk mund të paraqitet në cilësinë e eprorit direkt. Në këto rrethana, vlerësohet se ecuria disiplinore ndaj nëpunësi ***** është kryer në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, pasi ndodhemi në kushtet e veprimit në kapërcim të kompetencave nga ana e administratorit, që në rastin konkret ka sjellë një formim të gabuar të anëtarësisë së Komisionit Disiplinor.

Në lidhje me këtë problem, me përcaktimin e pozicionit dhe rolit të administratorit në shërbimin civil, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, është shprehur edhe më parë nëpërmjet vendimit nr. 59, datë 20.05.2016, “Mbi vlerësimin e ligjshmërisë të procedimit disiplinor për disa prej punonjësve të Bashkisë Tiranë, (Njësia Administrative Farkë)”, në përmbajtje të të cilit arsyetohet, gjithashtu, mungesa e kompetencës së administratorit, për t’u paraqitur në cilësinë e eprorit direkt gjatë zhvillimit të një ecurie disiplinore për nëpunësit civilë, të cilët ushtrojnë detyrën pranë njësive administrative të njësive të qeverisjes vendore.

Në këtë vështrim, edhe në rastin në fjalë, sjellja e administratorit si epror direkt, pa pasur delegim të kompetencës, në kuptim të nenit 108, pika “a”, të germës “i” dhe “iii”, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, bën që vendimi nr.26175/2, datë 26.09.2016, i Komisionit Disiplinor, për marrjen e masës disiplinore “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, të jetë një akt i nxjerrë nga një organ me përbërje jo të rregullt, gjë e cila passjell ushtrim diskrecioni në mënyrë jo të ligjshme (shih nenin 109, pika “dh”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”).

Një aspekt tjetër i kapërcimit të kompetencave të administratorit, konsiston dhe në kryerjen e procedurës së vlerësimit të pjesshëm të rezultateve në punë, për periudhën Janar – Qershor 2016, për punonjësin *****.

Vendimi nr. 109, datë 26.02.2014, i Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, në Kreun I, pika 2, germa “b”, “c” dhe “ç”, dhe Kreun III, përcakton në mënyrë të detajuar personat përgjegjës për kryerjen e vlerësimit të rezultateve në punë si dhe detyrat e kompetencat e secilit prej tyre gjatë kryerjes së këtij procesi, duke parashikuar se:

- b) **zyrtari raportues**, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative nëpunësin që do të vlerësohet;
- c) **zyrtari kundërfirmues**, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë zyrtarin raportues;
- ç) **zyrtari autorizues**, është nëpunësi që mbikëqyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në linjën e hierarkisë organizative zyrtarin kundërfirmues.

Në rastin konkret, nga këqyrja e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë, konstatohet se në ndarjen D, “Nënshkrimi”, administratori i njësisë administrative Nr. 8, ka nënshkruar njëkohësisht në cilësinë e zyrtarit raportues, zyrtarit kundërfirmues dhe zyrtarit autorizues, çka përcakton kundërligjshmërinë e këtij procesi.

Në kuptim të dispozitës së sipërcituar, duke qenë se struktura aktuale e njësive administrative, është e organizuar në nivel sektori, në ndarjen D, “Nënshkrimi”, të formularit standard, në cilësinë e zyrtarit autorizues duhet të kishte nënshkruar “Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimeve”, i cili është nëpunësi më i afërt sipas hierarkisë institucionale, në lidhje me përmbushjen e detyrave të nëpunësit *****.

Nga ana tjetër, në respektim të hierarkisë institucionale sipas strukturës aktuale të Bashkisë Tiranë, për sa arsyetuar në përmbajtje të këtij vendimi, në cilësinë e zyrtarit kundërfirmues duhet të nënshkruajë Drejtori i “Drejtorisë së objekteve në bashkëpronësi dhe zhvillimit të marrëdhënieve me Komunitetin dhe njësitë administrative”, e cila paraqitet si drejtoria përgjegjëse për bashkërendimin e marrëdhënieve me njësitë administrative dhe në vazhdimësi të linjës hierarkike, në cilësinë e zyrtarit autorizues duhet të paraqitet Kryetari i Bashkisë Tiranë.

Evidentimi dhe ndarja e roleve dhe të përgjegjësive sa më sipër, shërben si një mekanizëm për garantimin e të drejtave të nëpunësit civil, për kryerjen e një vlerësimi sa më objektiv dhe garantimin e të drejtës së ankimit dhe rishqyrtimit të vlerësimit, në rastet kur nëpunësi nuk është dakord me vlerësimin e dhënë ndaj detyrave të ushtruara prej tij.

Njëkohësisht, paligjshmëria në vlerësimin e rezultateve në punë konsiston dhe në mos respektimin e procedurës së përcaktuar në Kreun II, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë për nëpunësit civil”, i ndryshuar. Nga këqyrja e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë, konstatohet se rubrikat e këtij formulari nuk janë të shoqëruara me komentet përkatëse në lidhje me vlerësimin përfundimtar, arsyet e këtij vlerësimi si dhe me rekomandimet apo vërejtjet e nevojshme, që duhen ndjekur e plotësuar me qëllim arritjen e rezultateve dhe të objektivave më të larta. Kryerja e vlerësimit vetëm me pikë, cenon kryerjen e një procesi administrativ objektiv dhe të efektshëm për vlerësimin e performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil dhe për më tepër, përbën një paqartësi e konfuzion për nëpunësin, që në të ardhmen të përqendrohet në ato drejtime të treguara, me qëllim përmbushjen sa më mirë të detyrave.

Shkeljet e mësipërme, në kuptim të nenit 108, germa “a”, pika “ii” dhe “iii”, të “Kodit të Procedurës Administrative”, pasjellin pavlefshmërinë absolute të kësaj procedure si dhe në vështrim të nenit 109, pika “a” dhe “b”, të ligjit në fjalë, për mungesë të kompetencës dhe për shkelje të procedurës që duhet të respektohet, e bën formularin standard të vlerësimit një akt të paligjshëm.

Në këto kushte, nisur nga fakti që procedura e marrjes së masës disiplinore dhe e kryerjes së vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar- Qershor 2016, për nëpunësin ***** , janë absolutisht të pavlefshme, në bazë të nenit 110, pika 1, të ligjit të sipërcituar nuk mund të sjellin pasoja juridike, pavarësisht faktit nëse ato janë konstatuar si të tilla apo jo. Nisur nga detyrimi i parashikuar nga neni 111, i ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i

Republikës së Shqipërisë”, vetë organi publik, në këtë rast Kryetari i Bashkisë Tiranë duhet të konstatojë ekzistencën në këto veprime administrative të rasteve të parashikuara në nenin 108, të ligjit si më lart dhe njësia përgjegjëse në bazë të pikës 1, të nenit 113 të po këtij ligji, të drejtojë procesin për anulimin e masës disiplinore si dhe të formularit standard të vlerësimit në punë për periudhën Janar – Qershor 2016, për nëpunësin *****.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* si dhe nenin 16 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Bashkia e Tiranës dhe njësia e burimeve njerëzore, të drejtojnë procesin e konstatimit të pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. 26175/2, datë 30.09.2015, të Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”* dhe të formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor, 2016, për nëpunësin *****, në pozicionin *“Specialist Jurist”*, në Sektorin e Shërbimeve Mbështetëse, në Njësinë Administrative Nr. 8, të Bashkisë Tiranë dhe problemin t’ia paraqesë për zgjidhje Kryetarit të Bashkisë Tiranë.
2. Kryetari i Bashkisë Tiranë, për rregullimin e paligjshmërisë së procedurës disiplinore, të kryejë veprimet përkatëse ligjore, për anulimin e vendimit nr. 26175/2, datë 30.09.2015, të Komisionit Disiplinor për marrjen e masës disiplinore *“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”*, ndaj nëpunësit *****, si një akt absolutisht i pavlefshëm.

Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Tiranë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, duhet të fshijë masën disiplinore nga dosja personale e nëpunësit ***** dhe nga regjistri përkatës.

3. Njësia e burimeve njerëzore e Bashkisë Tiranë, në cilësinë e njësisë përgjegjëse, të drejtojë procesin për anulimin e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën Janar – Qershor 2016, për nëpunësin *****, duke treguar kujdes që përsëritja e procesit të vlerësimit të këtij nëpunësi, të bëhet në mënyrë objektive, në respektim të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”*, i ndryshuar, duke garantuar kryerjen e saj nga personat përgjegjës të ngarkuar nga ligji, respektimin e të gjitha fazave përkatëse të vlerësimit dhe duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës që materializojnë zhvillimin e këtyre fazave.

4. Për rregullimin e situatës në lidhje me funksionin e eprorit direkt, për nëpunësit civilë që ushtrojnë detyrën në njësitë administrative, njësia e burimeve njerëzore, duhet të marrë masa, që në kuptim të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe neneve 28 e 29, të ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* të përcaktojë rolin e administratorit dhe të kujdeset për delegimin e kompetencave, nëse do të vlerësohet e arsyeshme, për pozicionin e tij në raport me skemën e shërbimit civil.

Në kuadër të respektimit të ligjshmërisë së procedurave, ku sipas përcaktimeve të ligjit të posaçëm të shërbimit civil eprori direkt është organi kompetent për zhvillimin e tyre, njësia përgjegjëse e Bashkisë Tiranë, duhet të marrë masa për të unifikuar apo ekuivalentuar pozicionin e eprorit direkt, për nëpunësit civilë të njësive administrative, duke mbajtur në konsideratë strukturën aktuale mbi bazën e të cilës ushtron funksionet Bashkia e Tiranë dhe njësitë e saj administrative, si dhe përcaktimet e nenit 4, pika 1, germa “e”, dhe nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

5. Me qëllim garantimin e një administrimi sa më efektiv të marrëdhënieve në shërbimin civil, Bashkia Tiranë, në momentin e miratimit të strukturës së re, duhet të tregojë kujdes që të parashikohet funksionimi i saj sipas hierarkisë administrative, në përputhje me kërkesat e nenit 19, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, duke evidentuar në çdo rast rolet dhe funksionet e pozicioneve të shërbimit civil të këtij institucioni.
6. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë nga marrja dijeni për këtë vendim.
7. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse dhe institucioni i Bashkisë Tiranë, janë të detyruar të njoftojnë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
8. Të njoftohet për këtë vendim, Bashkia e Tiranës, dhe nëpunësi *****.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA